




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS**  
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



**KGJK. Nr. 174/2021**  
**Datë: 23 qershor 2021**

**KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK)**, në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 paragrafi 1 dhe 1.14 i Ligjit Nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 12 të Ligjit për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 13 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, në mbledhjen e 258-të, të mbajtur me datë 23 qershor 2021, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. Miratohet kërkesa e Gjyqtarit Valon Kurtaj për përjashtim si kryesues të panelit hetimor në lëndën disiplinore AD/KGJK/7/2021/GJTHPZ-ADGJTHP.nr.6/2021.
- II. Gjyqtari Vesel Gorani, anëtari rezervë i të njëjtit panel hetimor, caktohet kryesues.

**A r s y e t i m**


Këshilli Gjyqësor i Kosovës, me 23 qershor 2021, ka pranuar kërkesën e gjyqtarit Valon Kurtaj, për përjashtim, si kryesues i Panelit hetimor në lëndën disiplinore AD/KGJK/7/2021/GJTHPZ-ADGJTHP.nr.6/2021.

Kërkesën për përjashtim si kryesues i Panelit Hetimor në lëndën e lart cekur, Gjyqtari Kurtaj e mbështet në atë se me subjektin e hetimit disiplinor kanë punuar në të njëjtën gjykatë, respektivisht në Gjykatën Themelore në Prizren në Departamentin e Përgjithshëm. Përveç qe ka punuar bashkë në të njëjtën Gjykatë Themelore, Gjyqtari Kurtaj ka theksuar se me të njëjtin gjyqtar ka edhe lidhje miqësore dhe takohen shume shpesh. Gjithashtu, kërkesën e mbështet edhe në atë se me përjashtimin e tij në shërbim në këtë panel hetimor eliminohet dyshimi i palëve në objektivitet të panelit hetimor dhe rrjedhimisht ndikon në nxitjen e besimit të palëve dhe publikut në raport me punën e panelit hetimor dhe KGJK-së.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me 23 qershor 2021, pasi e shqyrtoj kërkesën për përjashtim të Gjyqtarit Valon Kurtaj si kryesues të panelit hetimor në lëndën disiplinore AD/KGJK/7/2021/GJTHPZ-ADGJTHP.nr.6/2021, vlerësoj se e njëjta kërkesë për përjashtim është e bazuar në nenin 13 të Rregullores për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve dhe njëzëri të njëjtën kërkesë e miratoj.

KGJK, si kryesues për të shërbyer në lëndën disiplinore AD/KGJ /7/2021/GJTHPZ - ADGJTHP.  
nr. 6/2021, caktoj anëtarin rezervë të panelit të njëjtë hetimor, gjyqtarin e Gjykatës Themelore në  
Prishtinë Vesel Gorani.

Skender ÇOÇAJ,  
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



*Kopje e vendimit i dërgohet:*

- Valon Kurtaj, gjyqtare në Gjykatën Themelore në Prishtinë;
- Vesel Gorani, Kryesues i Panelit Hetimor;
- Anëtarëve të Panelit Hetimor;
- Arkivit.